Data 26.09.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

"Prodhimi i emisioneve të Pullës për vitin 2022"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (**CPV**):

Pulla 22400000-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

20,544,080 (njëzet milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë) Lekë pa t.v.sh**.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.,** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht ***12 (dymbëdhjetë)*** për periudhen Qershor 2022 – Gusht 2022. Për plotësimin e kësaj kërkese, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një vërtetim për numrin e punonjësve të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për 3 muajt e fundit te maturuar ne daten e hapjes se ofertave, shoqëruar me listëpagesën e dorëzuar pranë organeve tatimore për periudhen Qershor 2022 – Gusht 2022 ne daten e hapjes se ofertave.

Argumentim*:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përllogaritur duke marr ne konsiderate sasine e mallrave te kerkuara objekt i kesaj kontrate, duke pasur parasysh edhe afatin e levrimit dhe te shperdarjes se

materialeve sipas specifikime teknike. Gjithashtu theksojme se pullat te cilat do te prodhohen sipas formateve te kerkuara, kerkojne linje prodhimi rrjedhimisht edhe punonjes perkates.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- makineri parapergatitje CTP (linje e kompletuar –Computer to Plate);

- makinë printuese Offset me 5 ngjyra;

- makineri birosje (perforimi) për pullën me krehrat përkatës;

- pajisje Densiometër ngjyre për përcaktimin e ngjyrave

Disponimi i makinerive te mesiperme te vertetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose ne rastin e marrjes me qira duhet paraqitur kontrate qiraje te noterizuar, etj.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të permbaje te dhena te mjaftueshme per identifikimin e qarte te makinerive/ pajisjeve te kerkuara.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kerkohen keto pajisje me qellim prodhimin e pulles te cilat parashikohen te prodhohen nepermjet linjes teknologjike prodhuese. Te gjitha llojet dhe formatet e makinerive dhe pajisjeve te kerkuara jane ne perputhje te plote me kerkesat dhe specifikimet teknike te mallrave/pulla qe kerkohen te furnizohen.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikatë **ISO 9001** për cilësinë e prodhimit të mallrave me elemente sigurie ose ekuivalente; (Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Vendosja e kritereve lidhur me certifikimet ISO bazohet në përputhje me parashikimin e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 44, të VKM-se, Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet

që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente, konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri eshte e bazuar ne faktin qe certifikatat ISO garantojne qe operatoret ekonomik zbatojne ne punen e tyre proçedura të çertifikuara ndërkombëtare për të garantuar shërbime me kualitet.

Ky kriter është përcaktuar për arsye se: ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarsisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo çertefikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

2.3.5. Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me çertifikatë **ISO 14298** për menaxhimin e sigurisë së procesit të prodhimit të mallrave me elemente sigurie ose ekuivalente; (Certifikata duhet te jete e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise).

Argumentimi: Vendosja e kritereve lidhur me certifikimet ISO bazohet në përputhje me parashikimin e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 44, të VKM-se, Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente, konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri eshte e bazuar ne faktin qe certifikatat ISO garantojne qe operatoret ekonomik zbatojne ne punen e tyre proçedura të çertifikuara ndërkombëtare për të garantuar shërbime me kualitet.

Ky kriter është përcaktuar për arsye se: ISO **14298** *specifikon të gjitha kërkesat për sistemin e* menaxhimin e sigurisë së procesit të prodhimit të mallrave me elemente sigurie. *Organizatat*

sigurojnë që kërkesat e sigurisë së konsumatorit janë përmbushur me kusht që këto të mos bien ndesh me kërkesat).

2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktojë se disponon ambiente ku do të kryhen proceset e prodhimit të pullës të cilat duhet të jenë të monitoruara me kamera 24 orë pa ndërprerje, gjatë gjithë kohës së prodhimit.

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinimin e letrës dhe për produktet e gatshme të siguruara me kamera sigurie. Për këtë duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë shitblerje ose kontratë dhurimi ose kontratë qiraje të ambientit, shoqëruar me dokumentacion pronësie të qiradhenësit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". *Për vetë rendesine qe ka ky objekt prokurimi lidhur me cilesine e pulles, kerkohet disponimi i ketij ambjenti nga ofertuesi, per ruajtjen ne ambjent te pershtatshem te lendes se pare Leter si dhe produktit perfundimtar te prodhuar. Disponimi i ketij ambjenti nga ofertuesi, krijon besueshmeri tek autoriteti kontraktor se operatori ekonomik ofertues ka kapacitete teknike per prodhimin e artikujve "pulla" si dhe ruajtjen e tyre në ambjente të pershtatshme me qellim te funksionimit sa me mire te artikujve*.

2.3.8. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakretistikave si më poshtë:

a) **Pesha totale e letrës me gjithë elementët e saj të jetë minimumi 95 gr/m2 deri në 105 gr/m2 maksimumi.**
b) **Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi.**
c) **Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV.**
d) **Letra e pullës postare të ketë bashkëngjitur skedën teknike të saj.**

***Autoritetin Kontraktor Posta Shqiptare sh.a* rezervon të drejtën që perpara fillimit te prodhimit të letrës të verifikojë sipas pikës 2.3.12**

2.3.9. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion tabak letre pulle postare në formatin A3, të birosur, sipas një nga përmasave të pullave të kërkuara në Skedën Teknike (referojuni formatit në mm), pa foto. (çdo kampion i paraqitur dorazi te jetë qartësisht i dukshem me firmë të perfaqesuesit dhe vulë të shoqerisë me qellim shmangien e çdo konfuzioni).

2.3.10. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letër pulle postare të bllokut 1/a sipas Skedës Teknike, format 80 x 60 mm (në brendësi i birosur 40 x 30 mm), pa foto. (çdo kampion i paraqitur dorazi te jetë qartësisht i dukshem me firmë të perfaqesuesit dhe vulë të shoqerisë me qellim shmangien e çdo konfuzioni).

Argumentim: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Dorëzimi i mostrave është shumë i rëndësishëm për procesin e vlerësimit teknik dhe verifikimit të përmbushjes së specifikimeve teknike.*

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Skeden teknike të letrës së pullës postare, e cila duhet të jetë lëshuar nga kompania prodhuese e saj.

2.3.12 Së bashku me dokumentacionin e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit, Operatori ekonomik ofertues, duhet të dorëzoje si pjesë të ofertës, një deklaratë, ku deklarohet se:

Përpara vlerësimit të ofertave në sistemin elektronik të prokurimit, Operatori Ekonomik ofertues, është i gatshëm dhe pranon Komisionin e vlerësimit të ofertave si dhe personat e autorizuar nga Autoritetin Kontraktor Posta Shqiptare sh.a., për verifikimin në vend të ambjenteve dhe të pajisjeve të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit për gjendjen fizike të makinerive si dhe provën e tyre nga punonjësit e operatorit ofertues në prani të përfaqësuesve të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor, për realizimin e prodhimit të Pullës Postare të vitit 2022.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që në çdo kohë pas nënshkrimit të kontratës dhe përpara fillimit të prodhimit të pullave të vitit 2022 të bëjë verifikime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe/ose Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe/ose prodhuesit për të vërtetuar funizimin me letrën e pullës të operatorit ekonomik.

Mos paraqitja e kësaj deklarate si dhe mospërmbushja në vend e deklaratës nga operatori ofertues, është kusht skualifikues.

Komisionit të vlerësimit të ofertave i lind e drejta që para shpalljes së klasifikimit të bejë verifikimin në vend të pajisjeve, të gjendjes teknike të tyre dhe ambjentit të kërkuar sa më sipër. Në rast të mos përmbushjes në vend nga operatori ofertues, Komisionit i lind e drejta e s'kualifikimit të ofertuesit.

Shenim: Bocetet që do të prodhohen, janë të formatuara në CD dhe do të kenë korigjime teknike para futjes në prodhim. Ndersa shkrimi për Cirkularët dhe Albumet do të faqoset në shtypshkronjën e operatorit fitues.

Ky material do të vendoset në dispozicion të Operatorit Fitues nga ana e AK në momentin e përshtatshëm për prodhimin e emisioneve të pullave postare, por jo më vonë se 3 (tre) ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës me procesverbal të nënshkruar nga përfaqësuesit e të dy palëve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ***duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar,*** *ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

Njësia e Prokurimit: